



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 42/2019

**PËR SHQYRTIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR TË PROJEKTLIGJIT
“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 12/2018, “PËR
VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË
SË SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET
E BRENDSHME DHE ANKESAT NË MINISTRINË E BRENDSHME””**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 28 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme””.

II. Shqyrtimi në Komisionin përgjegjës për Sigurinë Kombëtare të bëhet në datën 25-26.3.2019.

III. Amendamentet të dorëzohen në komisionin përgjegjës brenda datës 25.3.2019.

IV. Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet në datën 28.3.2019.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 21.3.2019